



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:120791

Datë: 25.11.2021

Numri i dokumentit: 02439420

C.nr.1520/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses N.Z. nga Shtime, të cilën e përfaqëson av.Fadil Sinanaj nga Gjilan, kundër të paditurës Komuna Shtime, në çështjen juridike pagesën e shpërblimeve jubilarë, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 25 nëntor 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia e paditëses N.Z. nga Shtime, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna Shtime që paditëses në emër të një pagë jubilarë t'ia paguaj shumën prej 550.82€ (pesëqind e pesëdhjetë euro e tetëdhjetë e dy cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124 € (njëqind e njëzetë e katër euro) të gjitha brenda afatit prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësja N.Z. përmes të autorizuarit të saj av. Fadil Sinanaj, më datë 15 qershor 2021 në këtë gjykatë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna Shtime, që në emër të shpërblimit jubilar paditësit ti paguaj 1 pagë jubilarë në shumë të përgjithshme prej 550.82€, në emër të 20 viteve përvojë të punës, duke konsideruar se tek e paditura është në marrëdhënie pune si Kryeinfermiere në Qendrën Kryesore të mjekësisë familjare në Shtime, paditësja ka kërkuar vetëm një pagë pasi pjesërisht e paditura ia ka paguar shpërblimin jubilar, edhe të ia ka paguar një pagë ndërsa i ka mbetur pa paguar edhe një pagë tjetër.

Gjykata me datën 07.07.2021 i ka dorëzuar të paditurës padinë, aktvendimin për përgjigje në padi dhe shkresat e tjera.

E paditura, më 15 korrik 2021, ka paraqitur përgjigje në padi, përmes së cilës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, duke kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ka theksuar se kontrata kolektive sektoriale, është e bazuar në kontratën e përgjithshme kolektive e cila u nënshkrua nga Qeveria e Kosovës dhe palët tjera zyrtare më 18.03.2014. Në kontratën e përgjithshme kolektive theksohet se obligimet financiare do të fillojnë të zbatohen në vitin 2015, por Qeveria e Kosovës nuk ka nxjerrë asnjë udhëzim administrativ për ta zbatuar kontratën kolektive sa i përket obligimit financiar dhe po ashtu edhe nuk ka ndarë mjete ashtu siç është zotuar me kontratën kolektive.

Ashtu siç është e përcaktuar në kontratën sektoriale të shëndetësisë dhe në kontratën e përgjithshme kolektive, shpërblimi jubilar është në vlerë të një page bazë e cila pagë është paga pa asnjë shtesë tjetër, kurse paga bruto dhe paga neto përmbajnë edhe shtesa tjera monetare.

Paditëses nuk i janë paguar pagat jubilarë, për arsyeje se nuk ka buxhet të mjaftueshëm e paditura, kurse Qeveria e Kosovës si nënshkruese e kontratës së përgjithshme kolektive, Ministria e financave e po ashtu as Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndarë buxhet për komunitat, për t i realizuar këto detyrime që rrjedhin nga kontrata kolektive.

Gjykata pa caktuar seancë gjyqësore, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës, përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune si Teknike e Stomatologjisë në Qendrën e mjekësisë familjare në Shtime dhe atë mbi 20 vite.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, për punëmarrësin dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës siç parashihet me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 17 pika 3.1. 3.2 dhe 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale është paraparë që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një pagë mujore, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy paga mujore, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave mujore, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan

shpërblimet jubilarë, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e arritjes së përvojës së punës të punëmarrësit-paditësit prej 20 vjet t'ia paguaj një pagë neto prej 550.82€, nga dita e arritjes së këtij kushti të cilin paditësja e ka plotësuar, siç shihet nga lista e pagës ku paditësi ka përvojë të punës 20 vite. Edhe sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së aprovuar, po ashtu kjo vërtetohet me listën e pagave, e bashkangjitur si provë, e që rezulton se paditësja gëzon pagë neto 550.82€.

Sa i përket kundërshtimit të paditurës se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 4 të kësaj kontrate e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive sektoriale dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Referuar dispozitës të cituar si më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, sepse kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë dhe se kundërshtimi i të paditurës, konsiderohet sipërfaqësor dhe gjuhësor kur thuhet se kundërshton kërkesëpadinë e paditësit dhe se kundërshtimi nuk ishte real dhe thelbësor, gjithashtu duke pasur parasysh se e paditura vetëm se i ka paguar paditëses një pagë, pra e njëjta e ka pranuar bazën juridike të kërkesëpadisë. Çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës është natyrës teknike, andaj gjykata ishte e bindur në mënyrën e vendimmarrjes, e që natyrshëm përveç qartësisë së kërkesëpadisë, gjykata i referohet edhe parimeve të procedurës civile, të normuara në nenin 10 par.1 të LPK-së, në të cilën dispozitë përcaktohet që çështja duhet trajtuar pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në

shumë prej 124 € dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 €, kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 20 €.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

C.nr.1520/21, me datën 25 nëntor 2021

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KESHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 (shtatë) dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.